

BASHKIA LEZHE

SHTOJCE

PER

**KRITERET E VECANTA TE PROKURIMIT ME OBJEKT” NDERTIM DHE
NDRIÇIM TROTUARI NE FSHATIN MANATI**

NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS/LOTIT : REF-18913-04-19-2019

Nisur nga asistimi dhe monitorimi qe Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i ka bere procedures se shpallur ne sistemin e prokurimit elektronik (SPE) me objekt “ **Ndertim dhe ndriçim trotuari ne fshatin Manati**

, **Numri i referencës së procedurës/lotit** : REF-18913-04-19-2019, me fond limit prej 11 954 772 (njembedhjetë milion e nenteqind e pesëdhjetë e kater mije e shtateqind e shtatedhjetë e dy) leke pa t.v.sh , vlera e financimit per vitin 2019 eshte ,1 666 667 (njemilion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë mije e gjashtëqind e gjashtedhjetë e shtate) leke pa t.v.sh , dhe vlera e mbetur eshte financim per vitin 2020,2021.

Njesia e prokurimit ka bere disa modifikime te kriterëve te vecanta kualifikuese sipas rekomandimeve te dhena nga APP-ja

1.Në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik , AK ka kërkuar: Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit.

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e hapjes se ofertave
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, nga data e hapjes se ofertave është te pakten sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Formularin e vleresimit (Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9), shoqëruar me
- Situacionin perfundimtar
- Akt kolaudimin

Ky kriter saktësohet si me poshte :

2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit.

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve

të fundit nga data e hapjes se ofertave

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, nga data e hapjes se ofertave është te pakten sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Formularin e vleresimit (Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9), shoqëruar me
- Situacionin perfundimtar
- Akt kolaudimin

Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem:

- Formularin e vleresimit (Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8), shoqëruar me
- Lejen e ndertimit
- Situacionin perfundimtar
- Akt kolaudimin
- Lejen e shfrytezimit
- Faturat tatimore te deklarimit te objektit ne organet tatimore.

Ne rast te kontratave te se njejtës natyre ne gjuhe tjeter , operatori ekonomik duhet ti paraqese ato te perktyjera ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara.

2.Në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar : Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NP – 1 Klasifikimi A
- NP – 4 Klasifikimi B

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NS – 5 Klasifikimi A
- NS – 6 Klasifikimi A
- NS – 18 Klasifikimi A

Liçensa sipas modelit te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi;

Agjencia e prokurimit Publik ka vleresuar se vendosja e nivelit B te klasifikimit per kategorine e licenses NP4 nuk eshte ne perputhje me natyren dhe permasat e kontrates *per kete arsye kriteri i mesipermodifikohet dhe behet si me poshte :*

Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NP – 1 Klasifikimi A
- NP – 4 Klasifikimi A

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NS – 5 Klasifikimi A
- NS – 6 Klasifikimi A

- NS – 18 Klasifikimi A
- Liçensa sipas modelit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

3.Në pikën 2.3.3 germa c dhe d të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar Stafi kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet, makinerite

- c. Shoqeria, përveç stafit drejtues, duhet të ketë në stafin mbështetës edhe minimumi 1 Inxhinier ndërtimi , 3 specialiste elektriciste , 3 karpentier , të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për 6 muajt të fundit nga data e hapjes së ofertave .
- d. **Per secilin duhet të paraqiten:**
- Kontrata individuale të punës
 - Diploma universitetit për inxhinierë, diploma e dhe certifikata e kualifikimit profesional për specialistët.

Agjencia e prokurimit Publik ka vlerësuar se bazuar në tipologjinë e objektit të kontratës dhe volumet dhe zërat e punimeve të preventivit , ekspertiza e një inxhinjeri ndërtimi do të ishte e mjaftueshme *per kete arsye kriteri i mesiperm modifikohet dhe behet si me poshte :*

Stafi kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet, makinerite

- c. Shoqeria, përveç stafit drejtues, duhet të ketë në stafin mbështetës edhe minimumi , 3 specialiste elektriciste , 3 karpentier , të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për 6 muajt të fundit nga data e hapjes së ofertave .
- d. **Per secilin duhet të paraqiten:**
- Kontrata individuale të punës
 - Çertifikata e kualifikimit profesional për specialistët.

4.Në pikën 2.3.4 të kapacitetit tekni, AK ka kërkuar, Shoqeria duhet të paraqesë Certifikata për objektin e prokurimit:

- ISO 9001-2015 (e vlefshme)
- OHSAS 18001-2007(e vlefshme)
- ISO 14001-2015 (e vlefshme)
- ISO 39001-2012 (e vlefshme)
- PAS 99-2012 (e vlefshme)
- ISO 50001 -2011 (e vlefshme)

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata në përputhje me zërat e punimeve të marra për sipër në kontratën e bashkëpunimit

Agjencia e prokurimit Publik ka vlerësuar se , dhe certifikata ISO 50001-2011 nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit *per kete arsye kriteri i mesiperm modifikohet dhe behet si me poshte :*

Shoqeria duhet të paraqesë Certifikata për objektin e prokurimit:

- ISO 9001-2015 (e vlefshme)
- OHSAS 18001-2007(e vlefshme)
- ISO 14001-2015 (e vlefshme)
- ISO 39001-2012 (e vlefshme)

- PAS 99-2012 (e vlefshme)

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese keto certifikata ne perputhje me zerat e punimeve te marra persiper ne kontraten e bashkepunimit

Mbështetur në përcaktimet e nenit 42 të LPP-së, data e hapjes se ofertave shtyhet me 5 dite .

data e hapjes se ofertave do te jete 08.05. 2019 ora 11:00

